



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 57 datë 21.12.2015

Për

**“MIRATIMI I PAGESËS PËR PAK E INVALIDËT E PUNËS
PËR PERIUdhËN 1-31 DHJETOR 2015”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 33, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar); neneve 7, 8, 11, 20, 23 dhe nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”(i ndryshuar); Ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e Invalidëve të Punës”(i ndryshuar); Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996, “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar); Ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000, “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”(i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.01.2001, “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 07.09.2006, “Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 869, datë 18.06.2008 për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Statusi i Invalidit të Punës”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 07.02.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno - sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.3, datë 10.03.2014 “Për planifikimin e fondeve të pagesave për aftësinë e kufizuar” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 22, datë 20.08.2015, mbi zbatimin e vendimit nr.618 datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuara” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 9, datë 25.02.2015, mbi zbatimin e vendimit nr. 404 datë 20.06.2012 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së kritereve dhe procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse”; Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 23, datë 20.08.2015, mbi zbatimin e vendimit nr. 31, datë 20.1.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik", (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 24, datë 20.08.2015, mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak Tiranë, sa më poshtë:

V E N D O S I:

1. Të miratohet pagesa për personat me aftësi të kufizuar, për muajin Dhjetor 2015 për Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Financës, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI